



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:096714

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05505191

C.nr.1145/20

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Agron Karatash, me bashkëpunëtorin profesional Ali Kosova, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.B., nga fshati Gërçinë, Komuna e Gjakovës, të cilin me autorizim e përfaqësojnë av. N.M., dhe av. D.Sh., nga Prizreni, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit 1,000 (një mijë) euro, pas mbajtjes së seancës përgaditore, me datë 26.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit A.B., nga fshati Gërçinë, Komuna e Gjakovës, me të cilën ka kërkuar që të **OBLIGOHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS” me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material dhe jo material për lëndimet e pësuar në kë të aksident paditësit A.B., t’ia kompensoj shumat si në vijim: në emër të dhimbjeve fizike 500 euro, në emër të frikës së përjetuar 300 euro, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj për çdo muaj 300 euro, në emër të ushqimit të përforcuar për çdo muaj 250 euro, në emër të shërimit klimatik 200 euro, në emër të rrobave të dëmtuara 150 euro, në emër të shërimit 150 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e gjerë te pagesa definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim, **OBLIGOHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS” me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material në automjet paditësit A.B., të i kompensojë shumë nën prej 1.000 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e shkaktimit të dëmit, duke u bazuar në nenin 26 të LSDA-së, e në afat prej prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim si dhe të **OBLIGOHET** e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS” me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore sipas T/A, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarrim” **SI E PA BAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësi A.B., nga fshati Gërçinë, Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarëve të tij av. N.M., dhe av. D.Sh., nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datën 13.08.2020, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve “BKS” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit 1,000 (një mijë) euro.

Në referatin e padisë kanë theksuar se me datë n 18.07.2020 në fshatin Gërçin, Komuna e Gjakovë s, ka ndodhur fatkeqësi komunikacioni, ku sipas raportit policor te aksidenti kishte ardhur nga pakujdesia e vozitë sit të veturës “A” e markë s Kombi Nissan, pa targa të regjistrimit e që i njëjti ishte duke tërhjekur një makinë për përpunimin e betonit dhe me të mbërritur në Rr. “Adem Gutaj” në fshatin Gërçinë në drejtimin për në fshatin Lipovec në një kthesë në të majtë dhe faktit se rruga ishte teposhtëze dhe për shkak të peshës së rëndë në pamundësi që të ndalet e humb kontrollin dhe me pjesën e përparme ballore e godet veturën “B” të markës Touran, tipi wolfsvagen, vit i prodhimit 2009, ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit, të cilës i shkakton dëm material dhe lëndime trupore pëson vozitësi, këtu paraqitë si i padisë A.B., Automjeti “A” si shkaktar i aksidentit në momentin e shkakimit të aksidentit ka qenë pa polisë të sigurimit, ku përgjegjësia bie mbi Byronë Kosovare të Sigurimeve “BKS”. Në vazhdim kanë theksuar se i dëmtuari A.B., menjë herë pas këtij aksidenti është dërguar në Qendrën Emergjente në Gjakovë, ku i është dhënë trajtimi mjekësor dhe janë konstatuar lëndimet e marra. Si pasojë e kë tij aksidenti, paditësi ka pësuar dëm material në automjet dhe lëndime trupore, të përcjella me dhimbje fizike, si dhe ka pësuar frikë të intensitetit të lartë si dhe të ulët, andaj mbi bazën e lartcekurave i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit në tërësi si e bazuar.

Me datën 25.03.2024, gjykata ka mbajtur seancën përgaditore në këtë çështje kontestimore, ku këtë seancë e ka mbajtur në mungesë të paditurës këtu Byrosë Kosovare të Sigurimeve “BKS” me seli në Prishtinë dhe në këtë seancë e autorizuara e paditësit av. N.M., nga Prizreni ka deklaruar se e njofton gjykatën se me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, andaj mbi bazën e kësaj dhe faktit se nuk ekziston më interesi juridik i palës paditëse, heqin dorë nga padia dhe kërkesë padia e paditësit dhe i propozon gjykatës që të marr vendim sipas dispozitave të LPK-së.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 3 par. 2 të LPK-së ku përcaktohet se- *Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë ujdj (pajtim) gjyqësorë lidhur me kontestin e tyre, si dhe sipas nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se “në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadiës apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë”).*

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 3 par. 2 dhe 149 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:096714, 26.03.2024

B.profesional
Ali Kosova

G j y q t a r i

Agron Karatash

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.